# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449051**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Etiketimi i kundërshtarëve si “spiunë” dhe “tradhtarë” para arrestimeve dhe vrasjeve – çfarë zbuloi gjykata në Hagë |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/etiketimi-i-kundershtareve-si-spiune-dhe-tradhtare-para-arrestimeve-dhe-vrasjeve-cfare-zbuloi-gjykata-ne-hage/1014335/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 11:58:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:53:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `99adb5430c38f2f5530f0b865d8f1d06d5e73a2303f0fe8b47c9200aebf9de7e` |
| TEKSTI | `ed290b5802477d4d8cfcbbcb0d572c2defd0bf00b70e5ad24835b37eb4b98a56` |
| PAMJA | `e79719e1a9d359b633208735a9555cf0761ec28c38f9cd004749793b7d9daeeb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8b7fb233659b085ed4081d18cd7eb73f5a71b292d51fc88d9018dea1a8e6a423` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8b7fb233659b085ed4081d18cd7eb73f5a71b292d51fc88d9018dea1a8e6a423`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Etiketimi i kundërshtarëve si “spiunë” dhe “tradhtarë” para arrestimeve dhe vrasjeve – çfarë zbuloi gjykata në Hagë



Personat që shiheshin si kundërshtarë politikë etiketoheshin sistematikisht si “tradhtarë”, “spiunë” dhe “bashkëpunëtorë të Serbisë”, përpara se të privoheshin nga liria, të keqtrajtoheshin dhe, në disa raste, të vriteshin. Ky është një prej zbulimeve kryesore të përmbledhjes së aktgjykimit të shpallur së fundmi në Hagë.

Trupi Gjykues theksoi se, me përjashtime tepër të pakta, mungonin provat që personat e ndaluar të kishin kryer vepra penale, të ishin përfshirë në beteja apo të paraqisnin ndonjë rrezik real. Gjykata nënvizoi gjithashtu se nuk pati fakte bindëse që shumica e viktimave të ishin vërtet bashkëpunëtorë apo spiunë, ashtu siç pretendonin elementët e UÇK-së.

Sipas trupit gjykues, gjatë seancave të marrjes në pyetje, të arrestuarve u kërkohej llogari për vendin e tyre të punës, për raportet e dyshuara me forcat serbe, për arsyen pse nuk i ishin bashkuar radhëve të UÇK-së dhe përse dyshoheshin për spiunazh. Madje, njërit prej të ndaluarve i ishte kërkuar shpjegim se përse nuk gjendej në krah të Thaçit.

Lista e akuzave që u ngarkoheshin të arrestuarve përfshinte një sërë cilësimesh. Ata trajtoheshin si “bashkëpunëtorë të Serbisë”, “spiunë”, “tradhtarë”, si dhe “ushtarë të Rugovës”. Gjithashtu, etiketoheshin si mbështetës të Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtarë ose simpatizantë të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës dhe kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në disa raste, personave u imponohej të hartonin deklarata me shkrim dhe të denonconin emra të tjerë njerëzish që dyshoheshin si bashkëpunëtorë. Megjithatë, gjykata arriti në përfundimin se këto arrestime, në disa situata, mund të ishin motivuar nga hasmëri personale. Pavarësisht kësaj, anëtarët e UÇK-së i zyrtarizonin privimet nga liria pa kontrolluar fare burimin apo vërtetësinë e kallëzimeve. Pas kësaj, të ndaluarit cilësoheshin si spiunë ose bashkëpunëtorë, i nënshtroheshin keqtrajtimit dhe, në raste konkrete, ekzekutoheshin.

të fundit/

Etiketimi i kundërshtarëve si “spiunë” dhe “tradhtar…

Mbrojtja e Jakup Krasniqit do ta apelojë aktgjykimin: Synimi…

Vendimi/ Dënimi i 4 ish-krerrëve të UÇK, kryegjykatësi Smith…

Publikohen shpërblimet financiare për klubet e Ligës së Evropës

Kusari-Lila: Aktgjykimi i sotëm është goditje e rëndë për Kosovën

Daut Haradinaj kërkon reagim të menjëhershëm të…

Ali Ahmeti: Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së është i…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Kjo skemë u përshkrua nga Trupi Gjykues si pjesë përbërëse e të ashtuquajturës “luftë speciale”: një narrativë e paramenduar që i paraqiste kundërshtarët si bashkëpunëtorë të strukturave serbe ose si pengesë ndaj qëllimeve të UÇK-së. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky tregim shërbente për t’i dhënë legjitimitet dhe shtysë dhunës së ushtruar kundër tyre.

Në veçanti, në shënjestër të kësaj narrative binin individë që lidheshin me forca të tjera politike dhe ushtarake, kryesisht me LDK-në dhe FARK-un. Po ashtu, në këtë kategori përfshiheshin edhe persona të dyshuar për lidhje me autoritetet serbe, si dhe anëtarë të komuniteteve rome dhe serbe.

Aktgjykimi i përket shkallës së parë dhe ndaj tij palët kanë të drejtën e ankimit.

Shtuar më 16.09.2026 13:53

Tags: Kundershtare , Shënjestrimi , Spiune , tradhtare , ushtarë të Rugovës



Limaj reagon pas aktgjykimit të Speciales: Ky vendim nuk është në em…


Mbrojtja e Jakup Krasniqit do ta apelojë aktgjykimin: Synimi mbetet lirimi i tij


Vendimi/ Dënimi i 4 ish-krerrëve të UÇK, kryegjykatësi Smith trego…


Kusari-Lila: Aktgjykimi i sotëm është goditje e rëndë për Kosovën


Daut Haradinaj kërkon reagim të menjëhershëm të Kosovës ndaj Gjykatës…


Djali i Kadri Veselit reagon pas dënimit me 18 vjet burgim



Andin Hoti kundër aktgjykimit të Speciales: “Jo në emër tim


Osmani pas vendimit të Hagës: UÇK-ja është krenaria më e madhe e…



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Kërko…
Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.